

 KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
19-12-2025			
Zyra Kombëtare e Auditimit Nacionalna Kancelarija Revizije National Audit Office		Nr. Prot. Prot. No.	Nr.faqeve Br. Stranica No. Pages
01	410	1288	6

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës Komora inženjera Republike Kosovo Chamber of Engineers of the Republic of Kosovo			
Njësia org. Org. Jedinica Org. Unit		Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	
OIRK		1002/2025	
Nr.faqeve Br. Stranica No. Pages		Data: Datum: Date:	
/		19.12.2025	
PRISHTINË / A			No.1



**ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Në zbatim të Nenit 12.1. të Ligjit Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr.17/10 Qershor 2016); si në mbështetje të Ligjit Nr.08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit; duke u bazuar në Statutin e Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës dhe Rregulloret tjera të Odës; si dhe duke u udhëhequr nga parimet e bashkëpunimit institucional, profesionalizmit dhe transparencës, palët nënshkruese bien dakord për lidhjen e kësaj marrëveshjeje me qëllim të forcimit të ligjshmërisë dhe integritetit profesional në fushën e ndërtimit në Republikën e Kosovës.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

Zyrës Kombëtare të Auditimit

(në tekstin e mëtejme "ZKA")

dhe

Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës

(në tekstin e mëtejme "OIRK")

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

1. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është përcaktimi i kushteve të përgjithshme të bashkëpunimit institucional ndërmjet Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, institucion i pavarur kushtetues që ushtron auditimin e financave publike dhe menaxhimin e aseteve publike dhe Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, institucion publik-profesional i pavarur që përfaqëson, licencon dhe mbikëqyr ushtrimin e profesionit të inxhinierëve në fushën e ndërtimit, me synim:

1.1. Zbatimin efektiv të Ligjit për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në institucionet publike që veprojnë në fushën e ndërtimit, infrastrukturës dhe urbanizmit;

1.2. Sigurimin që ushtrimi i profesionit të inxhinierit në sektorin publik bëhet vetëm nga persona me licencë të vlefshme të lëshuar nga OIRK-ja;

1.3. Rritjen e integritetit profesional dhe transparencës në proceset e projektimit, mbikëqyrjes, inspektimit dhe pranimit teknik;

1.4. Krijimin e mekanizmave të koordinimit profesional dhe këshillimit teknik ndërmjet institucioneve përkatëse.

Neni 2

Baza ligjore

1. Kjo marrëveshje mbështetet në:

1.1. Ligjin Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe akteve të brendshme të ZKA-së;

1.2. Ligjin Nr.08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit;

1.3. Statutin e OIRK-së; dhe


1.4. Rregulloret e brendshme të OIRK-së, që rregullojnë licencimin, rilicencimin, edukimin e vazhdueshëm profesional dhe mirëmbajtjen e regjistrave të anëtarëve.

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

1. Auditimi dhe zbatimi i ligjit për licencim

1.1. Zyra Kombëtare e Auditimit, gjatë auditimeve në ministri, komuna, ndërmarrje publike dhe institucione të tjera, do të verifikojë nëse:



1.1.1. të gjithë inxhinierët e përfshirë në proceset e planifikimit, projektimit, mbikëqyrjes, inspektimit, menaxhimit të kontratave, pranimeve teknike dhe kontrollit teknik posedojnë licencë të vlefshme të lëshuar nga OIRK-ja;

1.1.2. të gjitha dokumentet zyrtare të ndërtimit, përfshirë ditarët e punimeve, libra ndërtimore, protokollat e inspektimit, procesverbalet e pranimeve teknike, raportet e mbikëqyrjes dhe dokumentet e menaxhimit të kontratave, janë nënshkruar nga persona të licencuar nga OIRK-ja;

1.1.3. njësitë kërkuese dhe zyrat e prokurimit në institucionet publike sigurojnë përfshirjen e kërkesës për inxhinierë të licencuar në dosjet e tenderëve për punë ndërtimore.

2. Evidentimi dhe raportimi i shkeljeve

2.1. Në rast se gjatë auditimeve konstatohet se:

2.1.1. detyrat profesionale inxhinierike janë ushtruar nga persona pa licencë; ose

2.1.2. dokumentacioni teknik është nënshkruar nga persona të paautorizuar nga OIRK-ja, ZKA-ja do t'i evidentojë dhe raportojë këto raste në mënyrë zyrtare tek OIRK-ja për trajtim sipas Statutit dhe akteve nënligjore të Odës.

3. Mbështetje teknike dhe ekspertizë profesionale

3.1. OIRK-ja, në përputhje me rolin e saj si institucion profesional dhe licencues, nuk kryen vetë ekspertizë teknike, por mbështet Zyrën Kombëtare të Auditimit në identifikimin dhe përzgjedhjen e ekspertëve të përshtatshëm për nevojat e auditimeve në fushën e ndërtimit. Në këtë kuadër, OIRK-ja do të:

3.1.1. ofrojë mbështetje për identifikimin e inxhinierëve të licencuar që kanë përvojën dhe kualifikimet e kërkuara sipas natyrës së auditimit;

3.1.2. propozojë kandidatët e mundshëm nga regjistri i anëtarëve të licencuar, bazuar në kërkesën zyrtare të ZKA-së;

3.1.3. garantojë për vlefshmërinë e licencave dhe përputhshmërinë profesionale të personave të propozuar;

3.1.4. ndihmojë në sigurimin e standardeve të larta profesionale dhe etike gjatë kryerjes së detyrave nga ekspertët e angazhuar.

3.2. Ekspertët e përzgjedhur do të angazhohen dhe kontraktohen drejtpërdrejt nga ZKA-ja, sipas rregullave të brendshme të saj, ndërsa OIRK-ja nuk mban përgjegjësi financiare për angazhimin apo shpërblimin e tyre.

4. Edukimi dhe promovimi i profesionalizimit

4.1. Palët do të organizojnë aktivitete të përbashkëta, si trajnime, seminare dhe punëtori, për:

... KODI I ...
ZIRAKON ...
... KANCELAR ...
...
...
Shif. Kirit.
Klasif. Kod
Class. Code

- 4.2. rritjen e njohurive mbi ligjshmërinë e licencimit profesional;
- 4.3. promovimin e etikës dhe përgjegjësisë profesionale;
- 4.4. përmirësimin e praktikave të auditimit teknik dhe kontrollit të cilësisë në projektet publike.

Neni 4 **Detyrimet e palëve**

1. Zyra Kombëtare e Auditimit angazhohet që të:

- 1.1. integrojë verifikimin e licencimit profesional në analizat ligjore dhe operative gjatë auditimeve në sektorin e ndërtimit;
- 1.2. njoftojë OIRK-un për çdo rast të konstatuar të ushtrimit të profesionit pa licencë;
- 1.3. kërkojë nga OIRK-ja mbështetje për identifikimin e ekspertëve të licencuar, të cilët mund të angazhohen nga ZKA-ja në proceset që kërkojnë ekspertizë të specializuar teknike, në përputhje me natyrën e auditimit.

2. Oda e Inxhinierëve e Republikës së Kosovës angazhohet që të:

- 2.1. mirëmbajë dhe përditësojë regjistrin publik të inxhinierëve të licencuar, duke e bërë të qasshëm për verifikim institucional;
- 2.2. ndihmojë ZKA-në në procesin e përzgjedhjes së ekspertëve profesionalë, duke propozuar persona të licencuar që plotësojnë kriteret e kërkuara nga ZKA-ja në bazë të përvojës, fushës së ekspertizës dhe integritetit profesional;
- 2.3. ndërmarrë masa përkatëse ndaj shkeljeve të evidentuara në përputhje me Statutin dhe ligjin për Odat.

3. Palët, në mënyrë të përbashkët, zotohen që të:

- 3.1. respektojnë parimin e bashkëpunimit dhe transparencës së ndërsjellë;
- 3.2. mbajnë takime periodike, të paktën një herë në vit, për vlerësimin e zbatimit të marrëveshjes;
- 3.3. përgatisin raporte të përbashkëta për progresin dhe rezultatet e bashkëpunimit.

Neni 5 **Konfidencialiteti**

Të dhënat që shkëmbehen gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje në mes Palëve, do të përdorën dhe ruhen në harmoni të plotë me Ligjin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe aktet e brendshme të secilës palë..

Neni 6 **Koordinimi dhe zbatimi**

1. Secila palë cakton një pikë kontaktuese për koordinimin e aktiviteteve, raportimin periodik dhe inicimin e nismave të reja të bashkëpunimit.
2. Palët mund të krijojnë një komitet të përbashkët koordinues, që do të mbledhet sipas nevojës për të shqyrtuar progresin, sfidat dhe masat për zbatim efektiv të marrëveshjes. Gjithashtu, palët mund të nënshkruajnë Aneks Teknik për procedurat e raportimit dhe verifikimit të rasteve të shkeljeve të ligjit.

Neni 7 **Zgjidhjet e Mosmarrëveshjeve**

Në rast se në mes të palëve të kësaj Marrëveshjeje, paraqiten paqartësi, mospajtime apo për ndonjë arsye tjetër, palët do të përpiqen përmes bisedimeve për zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjeve.

Neni 8 **Ndryshimi i marrëveshjes apo shkëputja e saj**

1. Në raste të krijimit të rrethanave të reja, palët me kërkesë mund të iniciojnë plotësim/ndryshimin e kësaj marrëveshjeje;
2. Çdo ndryshim eventual i kësaj marrëveshjeje do të shtohet si aneks dhe hyn në fuqi me nënshkrimin nga palët zbatuese të kësaj marrëveshjeje.
3. Secila nga palët mund të tërhiqet brenda tridhjetë (30) ditëve pas paralajmërimit paraprakisht me shkrim.
4. Kohë e paralajmërimit do të merret data e pranimit të letrës paralajmëruese.

Neni 9 **Realizimi i shërbimeve**

Çdo aktivitet, angazhim apo shërbim profesional realizohet sipas kësaj marrëveshjeje dhe legjislacionit në fuqi për sa i përket kapaciteteve, buxheteve dhe procedurave të rregullta të secilës palë, përveç rasteve kur palët bien dakord ndryshe me marrëveshje të veçantë.

Neni 10 **Hyrja në fuqi**

1. Marrëveshja e Bashkëpunimit nënshkruhet më datën 19 / 12 / 2025 në Prishtinë, në dy (2) (2) ekzemplarë origjinal, nga një (1) për secilën palë nënshkruese.

REPUBLIC OF KOSOVO
PUBLIC AUDIT OFFICE

Mr. Besim
Mr. Stranica
Mr. Pano

2. Marrëveshja e Bashkëpunimit hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Palët, dhe ka afat prej tre (3) vjet, me mundësi të vazhdimit nëse palët pajtohen.

PALËT NËNSHKRUESE

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vlora SPANCA

Auditore e Përgjithshme

Për: Odën e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës

Arsim Rapuca

Kryetar

Prishtinë, 19 dhjetor 2025